

SUPERFLUID 21M1M

*Superplastifikues për beton, i përgatitur në bazë të polikarboksilateve sipas:
EN 934-2:T11.1 dhe T11.2*

FUSHA E APLIKIMIT

Prodhimi i betonit për transport me performancë të lartë, prej të cilëve kërkohet qëndrueshmëri të gjatë të gjendjes për përpunim dhe karakteristikave reologjike të betonit të freskët;

Superfluid 21M1M mundëson një shkallë të lartë reduktimi të ujit në beton, si dhe prodhimin e betonit të lëngshëm, me një klasë të lartë konsistence;

Përgatitja e betonit me karakteristika të larta të fortësisë;

Përgatitja e përzierjeve të betonit të destinuara për transport deri në 120 minuta dhe hedhja me pompë;

Transporti dhe hedhja e betonit në kushte të temperaturave të larta të ambientit;

Superfluid 21M1M është i përshtatshëm për përgatitjen e betonit të destinuar për hedhje me pompë në lartësi dhe largësi të mëdha dhe betonim të seksioneve të përforcuara dëndur me armaturë;

Përgatitja e betonit me shkallë të lartë të hidroizolimit dhe rezistencës ndaj ndikimeve dhe agresioneve atmosferike dhe të tjera;

Përgatitja e betonit të destinuar për betonim nënujor.

CILËSITË

- Mundëson reduktimin e ujit mbi 15%;
- Karakteristika të shtuara të fortësisë në fazë të hershme dhe përfundimtare;
- Rrit kompaktësinë dhe hidroizolimin e betonit;
- Përmirëson karakteristikat fiziko-mekanike të betonit
- Mundëson rritjen e rezistencës ndaj veprimit të akullit dhe kripërave;
- Mundëson rritjen e qëndrueshmërisë së betonit;
- Mundëson rritjen e rezistencës ndaj karbonizimit të betonit;
- Mundëson rritjen e rezistencës ndaj ndikimeve atmosferike;
- Mundëson hedhjen e lehtë të betonit

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

CILËSI	METODA	VLERA E DEKLARUAR
Pamja	Vizuele	Lëng ngjyrë kafe
Masa e volumenit (në 20°C)	ISO 758	(1.06±0.02) g/cm³
pH-vlera (në 20°C)	ISO 4316	3,5-5,5
Përmbajtja e klorureve	EN 480-10	≤0,1%
Përmbajtja e alkaleve	EN 480-12	≤2,0%

DOZIMI DHE PERFORMANCA

Doza optimale e Superfluid 21M1M-it është nga 0,4 deri në 1,2% të masës së çimentos në përzierjen e betonit. Me këtë dozë arrihet një reduktim i ujit prej në 15% në krahasim me vlerat referente.

Doza optimale e Superfluid 21M1M-it përcaktohet më së miri nga teste paraprake laboratorike ose industriale.

Në kushte të temperaturave të larta të ambientit, ose në rast se prodhimi, transporti dhe hedhja e betonit zgjat më shumë se 90 minuta, betoni i freskët gjatë prodhimit duhet të përgatitet me një klasë konsistence më të lartë - S4 ose S5.

Dozimi i aditivëve bëhet me dorë ose automatikisht gjatë prodhimit të betonit. Efekti më i mirë arrihet kur Superfluid 21M1M shtohet së bashku me 20-30% të sasisë së fundit të ujit të nevojshëm në beton, në

agregatin paraprak të përzier të çimentos dhe 80% të ujit në beton. Kohëzgjatja e rekomanduar e përzierjes së betonit të freskët me shtimin e Superfluid 21M1M-it nuk duhet të jetë më e shkurtër se 90 sekonda. Efektet e mbidozimit: Doza e tepërt e Superfluid 21M1M-it mund të shkaktojë ndarje të betonit.

KOMPATIBILITETI

Superfluid 21M1M është kompatibel me disa aditivë nga programi ADING të grupit të përshpejtuesve dhe ngadalësuesve të lidhjes, aditivëve të betonimit dimëror, aditivëve hidroizolues, aerantëve etj. Nëse dy ose më shumë aditivë përdoren njëkohësisht në përzierjen e betonit, është e nevojshme të kryhen teste paraprake.

Aditivët e ndryshëm në beton dozohen veçmas (nuk përzihen me njëri-tjetrin përpara se të dozohen në përzierjen e betonit). Superfluid 21M1M është kompatibel me të gjitha llojet e çimentos (duke përfshirë edhe çimentot rezistente ndaj sulfatit).

PAKETIMI

Kanta plastike: 20 kg

Fuçi: 200 kg

Kontejnerë: 1000 kg

RUAJTJA NË DEPO

Në paketimin original, të mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë i rrezeve të diellit, në një temperaturë prej +5°C deri +35°C. Afati i përdorimit 12 muaj.

SHENJA E CERTIFIKIMIT TË PRODHIMIT



ADING AD Shkup

Novoselski pat (rruga 1409) nr. 11, 1060

Shkup, Maqedoni
08

GACD001/6

EN 934-2:2009+A1:2012

SUPERFLUID 21M1M

Përzierje betoni, superplastifikues/ngadalësues

EN 934-2:T11.1&11.2

Përmbajtja e joneve të klorit $\leq 0,1\%$ sipas masës

Përmbajtja e alkaleve $\leq 2,0\%$ sipas masës

Veprimi korroziv **Përmban vetëm komponentë sipas EN 934-1:2008, Aneks A.1**

Rrezik për shëndetin: Superfluid 21M1M nuk përmban substanca toksike, por pavarësisht kësaj, duhet të keni kujdes që materiali të mos bie në kontakt me lëkurën, sytë ose të gëlltitet. Në rast kontakti me lëkurën ose sytë, është e nevojshme shpëlarja e menjëhershme me ujë të pastër të rrjedhshëm. Nëse gëlltitet, kërkoni kujdes mjekësor. Informacion shtesë jepet në Fletën e të Dhënave të Sigurisë së Produktit.

Zjarri: Superfluid 21M1M është një lëng jo i ndezshëm. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së Produktit.

Pastrimi dhe asgjësimi: Mbetjet e produktit Superfluid-21M1M pastrohen me ujë. Paketimi i vjetër i përdorur duhet të hidhet sipas rregullatës lokale për atë lloj mbeturinash. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së Produktit